

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË,
Departamenti i Përgjithshëm
Divizioni i Kundërvajtjes

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË,-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni i Kundërvajtjes me gjyqtarin Mustafë Selimi dhe procesmbajtësen Shqipe Hajdari, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Osman Sejfi nga Prishtina, për kundërvajtjen nga neni 5,6 par.1,2 dhe neni 17 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollën e Pasurisë të Zyrtarëve të lartë publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat zyrtar, e në bazë të nenit 73,74,195,198 al. 1 pika 2 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, merr këtë:

A K T V E N D I M

PEZULLOHET: Procedura kundërvajtëse kundër të pandehurit Osman Sadik Sejfi-pensionist, i lindur me 1948 në fsh.Gllogjan tani jeton në Prishtinë rr.Kalabrija objekti 2 ban.nr.17, për kundërvajtjen nga neni, 5,6 par.1,2 dhe neni 17 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollën e Pasurisë të Zyrtarëve të lartë publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat zyrtar.

Procedura Pezullohet për shkak se ekzistojnë rrethana që e përjashtojnë përgjegjësinë kundërvajtëse konform nenit 198.al.1.pika 2 të Ligjit mbi Kundërvajtjet

Shpenzime të procedurës nuk ka patur.

Nga një kopje të këtij aktvendimi duhet dërguar palës dhe ushtruesit të kërkesës.

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsionit në Prishtinë, parashtroj gjykatës kërkesën nr.01-1806/2012 më dt. 22.05.2012 për fillimin e procedurës kundërvajtëse kundër të pandehurit Osman Sejfi dhe për kundërvajtjen nga neni 5,6 par.1,2 dhe neni 17 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollën e Pasurisë të Zyrtarëve të lartë publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat zyrtar.

Sepse si zyrtarë i lartë publik nuk e ka përmbushë obligimin ligjor për deklarimin e pasurisë për vitin 2012.

Në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur më datë 23.05.2013, i pandehuri me rastin e marrjes në pyetje thekson se deklarimin e pasurisë pranë Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2012 e ka bërë me një javë vonesë për shkak të sëmundjes shumë serioze me çrast ka qenë i obliguar ti nënshtrohet një operacioni më datë 27.02.2013, e pastaj dy muaj ti nënshtrohet tretmanit fiziatrik.

Tani për shkak të pensionimit nuk është duke e ushtruar funksionin e drejtorit të Klinikës së Kirurgjisë-Maksilofaciale dhe kërkon nga Gjykata që të ketë për bazë këto rrethana me rastin e marrjes së aktvendimit

Nga të dhënat e parashtruara në kërkesë, nga deklarata e të pandehurit si dhe nga provat materiale të deponuara në lëndë: Raporti i lëshuar nga Qendra Klinike Univerzitare e Kosovës-Instituti i Radiologjisë në Prishtinë mbi ekzaminimin e shtyllës kurrizore të profesor Osman Sejfisë si dhe nga Raporti i Poliklinikës, shihet se i njëjti është pranuar për operim të Hernisë Diskale të verifikuar me MRI të L/S- kurrizit dhe operacioni është kryer më datë 27.02.2013. Tretmani mjekësor-fiziatrik ka zgjatë dy muaj pas operacionit dhe këto kanë qenë pengesat e arsyeshme, të cilat kanë ndikuar që i pandehuri formularin për deklarimin e pasurisë për vitin 2012, mos ta dorëzojë në afatin e caktuar ligjor, andaj Gjykata konstaton se ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë kundërvajtëse dhe në vështrim të nenit 198 par.2 të LMK-së e Pezulloi procedurën.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Apelit në Prishtinë 8 ditë pas marrjes së të njëjtit nëpërmjet kësaj Gjykate pa taksë..

U VENDOS NË GJYKATËN THEMELORE -DIVIZIONI PËR KUNDËRVAJTE NË PRISHTINË

Më dt. 29.05.2013



REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA E KOSOVES		AGENCIJA KUNDËR KORRUPSIONIT / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Eqp.		Nr. Prot.	
Dep.	DPK/DMP	Br. Prot.	03-1979/13
Nr. i treg.		Prot. No.	
Bro. shënime	01	Data	02.07.2013
Nr. pages		Datum	
PRISHTINE			